Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0782

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv.Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahimi, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Axiom Engineering Sh.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Renovimi i depos për ARC në objektin e ish Rilindjes me numër të prokurimit 214-24-6659-5-2-1, me 29/10/2024, mori:

Vendim

1.Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Axiom Engineering Sh.P. K me nr. 2024/0782 e datës 01/09/2024, kurse Njoftimi mbi vendimin e AK Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me aktivitetin e prokurimit ‘’Renovimi i depos për ARC në objektin e ish Rilindjes’’, me numër të prokurimit 214-24-6659-5-2-1, mbetet në fuqi për anulim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues ‘’Axiom Engineering Sh.P.K’’ Aprovohet si pjesërishtë e bazuar, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 02.07.2024 Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me Renovimi i depos për ARC në objektin e ish Rilindjes me numër të prokurimit 214-24-6659-5-2-1.

Ndërsa me datën 16.08.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 70,000.00 €.

Me 20.08.2024 OE Axiom Engineering Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 23.08.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 30.08.2024 OSHP ka pranuar ankesën nga OE Axiom Engineering Sh.P.K me nr. 0782/2024 për lidhur me aktivitetin Renovimi i depos për ARC në objektin e ish Rilindjes me numër të prokurimit 214-24-6659-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Axiom Engineering Sh.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : "Grupi i OE AXIOM ENGINEERING SH.P.K, ARCHI TIME SH.P.K. paraqet këtë Ankesë me pretendimet për shkelje të natyrës absolute, të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr.04/l-42 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092(Versioni i Konsoliduar) neni 1 i LPP- Qëllimi, neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, neni 41 RRUOP Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, paraqesim këtë Ankesë duke konsideruar që Autoriteti Kontraktues gjatë procedurës të vlerësimit të tenderëve ka bërë shkelje të dispozitave të cilat derivojnë në nevojën e anulimit të vendimit. Ne si Operator Ekonomik me datë 16.08.2024 kemi pranuar letrën standarde për anulimin e aktivitetit të prokurimit "Renovimi i depos për ARC në objektin e ish Rilindjes" me nr. Prokurimit 214-24-6659-5-2-1, me pretendimin e Autoritetit Kontraktues se tenderi ynë është eliminuar për arsyet: Arsyeja e 1-re e pretenduar nga AK-së për eliminimin tone: Lista e çmimeve - Pjesa II. Paramasa dhe Parallogaria, është e papranueshme sepse tenderi juaj është jo normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës dhe Ju keni dorëzuar një tender të pazbatueshëm. Përgjigje ne arsyen e 1-re te pretenduar nga AK-së për eliminimin tone: Ju si AK keni bere shkelje duke mos bere vlerësim te drejte te ofertës sonë dhe një gjë e tille shihet edhe ne arsyet te cilat keni përdorur për eliminimin tone. Përmes letrës me temë "Përgjigjja e Letrës për Sqarim të Tenderit_09.08.2024" kemi deklaruar (citat): "Siç e kemi nënshkruar dhe kemi deklaruar në Aneksin 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme dhe Deklaratat tjetra ne Deklarojmë me përgjegjësi materiale dhe ligjore se do ti realizojmë të gjitha shërbimet në për puthshmëri dhe standardet e cekura në specifikimet teknike të parapara në

dosjen e tenderit për projektin në fjalë." dhe "Ne jemi të gatshëm për ti realizuar punimet me çmimet e ofruara në ofertë dhe ju ri-theksojmë se çmimet nuk janë jashtëzakonisht të ulëta as në krahasim me ofertat tjera, as me parallogaritë e NJK të MPB-së dhe as me çmimet e tregut." Ne letrën sqaruese B41. Letër standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo normalisht te ulet, AK ka marrë mesatare nga 4 ofertuesit tjerë te cilët janë te papërgjegjshëm dhe te cilët nuk mund as te mirën ne krahasim me oferten tone, pasi qe sipas LPP-se, për krahasim duhet te mirren vetëm ofertat te cilat janë te përgjegjshme. Nga kjo mund te shihet qarte qe komisioni nuk ka njohurinë e mjaftueshme te LPP-se, ose ka tendence qe kjo lende te kthehet ne ritenderim. Gjithashtu kemi bërë shpjegimin e elementeve përbërëse të ofertës sonë sipas kërkesës së AK. Por prapë se prapë AK ka bere eliminimin tonë me pretendim se përgjigjja jonë është e pamjaftueshme dhe jo bindëse. Në mënyrë që ju ta kuptoni më mirë Nenin 41 të Rregullores Nr.001_2022 për prokurim publik po ju demonstrojmë Rregullat për Tenderët Jo-normalisht të Ulët, respektivisht Nen-neni 41.3 (citat): "41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë" Në formën tabelare të bashkangjitur sipas Nenit 41 të Rregullores Nr.001_2022 për prokurim publik, gjegjësisht Nen-neni 41.3 po tregojmë që ne dhe asnjë nga operatoret tjerë nuk kane ofertuar me çmime të cilat mund të konsiderohen Jo-normalisht të Ulëta, edhe pse jo asnjë nga ofertat e tjera përpos ofertës tonë nga ana juaj nuk është marr si oferte e përgjegjshme. Ne këtë rast, ky arsyetim është i pashpjegueshëm, se si mund te llogaritet tender jo-normalisht i ulet edhe nëse te gjitha ofertat do te ishin te përgjegjshme. Nga ky arsyetim i komisionit, do te thotë qe ne ri tenderim çdo oferte qe do te jete ne çmimin tone ose me te ulet do te llogaritet tender jo-normalisht i ulet. Kjo është ndërhyrje direket ne Ekonominë e tregut dhe konkurrencën e drejte ne mënyra qe AK-ja te përfitoj duke marr ofertën me te lire, pasi qe edhe kushti për tenderin ne fjale është çmimi me i lire. Arsyeja e 2-te e pretenduar nga AK-së për eliminimin tone: Bazuar në përvojën Jo të mirë me ju si kontraktues, pasi që MPB-ja pas përpjeke miqësore e mosmarrëveshjeve të Kontratës dhe vërejtjeve të shumta, është detyruar dhe i ka shkëputur kontratën me titull: "Renovimi në objektin e IRK-së, vendosja e pikave kontrolluese Ritender me numër identifikues: 214-23-4243-5-2-1-C333" pikërisht për shkak të ofertimit me çmime jo normalisht të ulëta dhe mosrealizimit të kontratës në pajtueshmëri me kushte të kontratës. Përgjigje ne arsyen e 2-te te pretenduar nga AK-së për eliminimin tone: Edhe ky pretendim i AK-së është i pasakte i pavërtetë dhe i qëllimshëm sepse për një zyrtar i cili te paktën njëherë ka shfletuar ligjin për prokurim publik ose web faqen e KRPP-se do ta kuptonte se kjo arsye e pretenduar është skandaloze për faktin që AK-së ka futur ne vlerësim ofertën tone edhe pse ka pretenduar se ne jemi te papërshtatshëm por papërshtatshmërinë tone e ka bazuar ne disa te pavërteta dhe te paqëndrueshme, pra AK ka hamendësuar se ne jemi te papërshtatshëm. Për t'ju sqaruar me shume për këtë arsye skandaloze te pretenduar nga AK ju lutemi ti referoheni interpretimeve te KRPP-se: 17. 22.11.2022 Në rast se kontraktuesit (operatorit ekonomik) iu ka shkëputur kontrata dhe i njëjti nuk e ka atakuar Vendimin e Autoritetit Kontraktues, a mundet Autoriteti Kontraktues të përjashtojë Operatorin Ekonomik nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për një periudhë të caktuar nga data e vendimit për shkëputje? Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-02 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin e dispozitave 3.2 dhe 4.7 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: "Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve" rregullohet me nenin 65 të LPP-së. Neni 65 i LPP, në mënyrë të veçantë paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 përcakton: 3. "Operatori

ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara: • është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rëndë profesionale e konstatuar nga një gjykatë kompetente;" • Në anën tjetër, paragrafi 4, nën paragrafi 4.7 i nenit 65 të LPP-së, përcakton: 4. "Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik: • gjatë tri viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë njësi publike, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë ose diku tjetër; • Të dy rastet e specifikuara në dispozitat e lartë cituara, mund ti referohen rastit për të cilin është parashtruar pyetja. Por në të dy rastet, të dy dispozitat kërkojnë një Vendim përfundimtar nga Gjykata i cili vërteton sjelljen e paligjshme të operatorit ekonomik. Në rastin për të cilin është parashtruar pyetja, shkelja e kontratës në fakt nuk është dërguar para Gjykatës, kështu që vendimi i Gjykatës në lidhje me këtë rast mungon. Prandaj, në përputhje me dispozitat e lartë cituara, OE nuk mund të përjashtohet dhe të deklarohet i pa përshtatshëm në procedurën e tenderit përkatës. Si përfundim, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues qe te bej anulimin e këtij vendimi skandaloz i cili është bere ne shkelje te rende te LPP-se dhe Ligjeve ne fuqi dhe këtë lende ta ktheje ne rivlerësim duke respektuar dispozitat e LPP-se dhe duke marre ne konsiderate te gjitha shkeljet e evidentuara."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE Axiom Engineering Sh.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 61, 65 te LPP-së.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim : "Përgjigje në pretendimet e lartë cekura (Neni 1, Qëllimi) Ministria e Punëve të Jashtme të Brendshme, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e pretendimit se Autoritetin Kontraktues e ka shkelur Nenin 1 i LPP-së (Qëllimi) është i pabazuar, sepse gjatë vlerësimit Autoriteti kontraktues ju ka përmbajtur këtij Neni e ka arritur Qëllimin e paraparë në këtë aktivitet të prokurimit, si është paraparë ne nenin 1 të LPP -së. Përgjigje në pretendimet e lartë cekura (Neni 6, Ekonomicitetit dhe Efikasiteti). Pretendimi i tenderuesit ankues Grup i OE, "Axiom Engineering" Sh.P.K & "ARCHI Time" Sh.P.K., Prishtine, thotë së AK me rastin e vlerësimit te lendeve dhe eliminimit të këtij tenderuesi, ka shkelur Neni 6 i LPP-së - Ekonoiniciteti dhe Efikasiteti, pasi që nuk është kujdesur që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, është i pabazuar, sepse me rastin e publikimit të Njoftimit mbi vendimi e Autoritetit Kontraktues me të cilin është anuluar aktiviteti i prokurimit, AK e ka anuluar këtë procedurë të prokurimit, mbështetur në nenin 62, pika 1. të LPP-se, pasi nuk është pranuar asnjë tender i përgjegjshëm, a ndaj nuk kemi të bëjë me shkelje të Nenit 6 të LPP-së, sepse AK me këtë veprim ka respektuar këtë Nen dhe siguron që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 7) Pretendimi i tenderuesit ankues Grup i OF, "AXIOM ENGINEERING" SII.P.K & "ARCHI TIME" SH.P.K., Prishtinë, thotë se AK me rastin c vlerësimit te tenderëve, ka shkelur Neni 7 i I.PP-së - Barazia në Trajtim jo-Diskriminim , është i pabazuar, sepse me rastin e vlerësimit, AK ka konstatuar se Tenderi i juaj mbështetur me nenin 61 pika 4 të LPP-së. Ju kemi njoftuar për refuzimin të tenderit jo-normalisht c ulët. Në listën e çmimeve, gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te oferta e Juaj Komisioni vlerësues, ka hasur çmime jo-normalisht të ulëta, çmimet janë jashtëzakonisht të ulëta (2. Punët e Arkitekturës, çmime jo-normalisht të ulëta, në 7 artikuj dhe të 3. Punët e Elektrikes Dhe Alarmi çmime jo-normalisht të ulëta, në 15 artikujt në krahasim me çmimet e ofertave tjera, jashtëzakonisht të ulëta me parallogaritë e njësisë kërkuese të MPB-së për këtë tender dhe me çmimet e tregut, andaj në këtë rast AK me eliminimit luaj nga ky aktivitet i prokurimit ju ka

trajtuar në mënyrë të barabartë dhe nuk kemi lë bëjë me kurrfarë diskriminimi e as favorizimi të asnjë ofertë pjesëmarrëse, andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me shkelje të Nenit 7 të LPP-së. Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 59) Pretendimi i tenderuesit ankues Grup i OE, "AXIOM ENGINEERING" SH.P.K & "ARCHI TIME" Sh.P.K., Prishtinë, thotë se AK me rastin e vlerësimit le tenderëve, ka shkelur Neni 59 i LPP-së Ekzaminimit, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve, nuk qëndron, sepse-Autoriteti Kontraktues, pasi ka shqyrtuar me kujdes kërkesën për rishqyrtim, konstaton edhe një herë se nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit, sepse AK gjatë vlerësimit të tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit iu ka përmbajtur dhe ka zbatuar nenin 59 par. 4 Lë LPP-së, citojmë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri një të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjet e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: 1. Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm: Formularin e paraqitjes së tenderit, lista e çmimeve- Pjesa II. Paramasa dhe Parallogaria, është e papranueshme sepse tenderi juaj është jo normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës ju keni dorëzuar një tender te pazbatueshëm. Përgjigjet nga ana e Juaj, lidhur me çmimet Jo-normalisht të ulëta, në pajtueshmëri me Nenin 41.10. pika b. të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik janë të pamjaftueshme, jo bindëse për komisionin vlerësues dhe Autoritetin Kontraktues. Autoriteti Kontraktues vlerësimin e cekur më lartë e bazon me kalkulime dhe argumente konkrete dhe konstatimi se keni dorëzuar tender me çmime Jo-normalisht të ulëta, po ashtu është bazuar edhe në përvojën Jo të mirë me ju si kontraktues, pasi që MPB-ja pas përpjekjeve për zgjidhje miqësore e mosmarrëveshjeve të Kontratës dhe vërejtjeve të shumta, është detyruar dhe i ka shkëputur kontratën me titull: Renovimi në objektin e IRK-së, vendosja e pikave kontrolluese Ri- tender me numër identifikues: 214-23-4243-5-2-1-C333, pikërisht për shkak të ofertimit me çmime jo normalisht të ulëta dhe mos realizimit të kontratës në pajtueshmëri me kushtet e kontratës, Mbështetur në këtë që u tha më lartë në pajtueshmëri me nenin 61 pika 4 të LPP-së Ju jeni njoftuar për refuzimin të tenderit tuaj jo-normalisht e ulët. Në pajtueshmëri me nenin 61 pika 5 e LPP -së Autoriteti Kontraktues brenda afatit ligjor e ka njoftuar KRPP-në për refuzimin e tenderit dhe oferta juaj nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm. Andaj nga arsyet e cekura më lartë, oferta juaj është refuzuar dhe nuk ka kaluar në vlerësimin e mëtutjeshëm.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 04/09/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0782/2024, ndërsa me datë 13/09/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/0782 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues është Pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit, Ndërsa OE nuk është Pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Axiom Engineering Sh.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0782 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë : "Aktiviteti i prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i depos për ARC ne objektin e ish Rilindjes" me nr. të prokurimit: "214-24-6659-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri i dhënies çmimi më i ulët i përgjegjshëm. AK në vendimin B58 të letrës standarde ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se nuk ka oferta të përgjegjshme. Tutje OE ankues nga është eliminuar me arsyetimin: Si rrjedhoj, OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, I njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat duke shkelë dispozitat ligjore të LPP-se përkatësisht nenet:1,6,7,59,60,61,65. OE ankues, pretendon se AK ka bërë llogaritje sipas formulës për tenderët jo normalisht të ulët me ofertat të cilat janë të pa përgjegjshme, duke mos kuptuar drejtë veprimin. Gjithashtu pretendon se nuk mund te eliminohet me arsyen se ka reference të dobët, përderisa nuk ka ndonjë vendim nga gjykata. Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës në platformën E prokurim sqaron se, AK gjatë vlerësimit të ofertave, të cilat kanë qenë gjithsej pesë ofertues, të cilët janë eliminuar secili për disa arsye të ndryshëm, kurse OE ankues është eliminuar me arsyetimin se për disa pozicione i njëjti ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta krahasuar me çmimin e tregut, rrjedhimisht gjatë vlerësimit, AK kërkon sqarime nga OE ankues konform rregullores për Prokurim publik nr.01/2022 neni 41, dhe si e tillë pas përgjigjes nga OE ankues, I cili ka sqaruar se çmimet nuk mund të konsiderohen jo normlisht të ulëta përderisa janë përafërsisht të njëjta sikur të operatorëve të tjerë, si dhe nuk janë as shumë ulët nga vlera e parashikuar nga ana juaj si AK, duke sqaruara gjithashtu se qëndron prapa çmimeve të ofruara dhe duke dhënë një sqarim lidhur me pyetjet e parashtruara nga ana e AK-së, mirëpo AK përkundër përgjigjes, të njëjtit nuk pranuan sipas bindjes së tyre sqarimin e dhënë nga OE ankues, dhe si e tillë eliminuan të njëjtin me arsyen si më lartë, dhe si e tillë sipas shkresave të lëndës, AK konform rregullores për prokurim publik nr.001/2022 neni 41.3, 41.4, ka ndjekur hapat dhe si përfundim, bazuar në nenin 41.10 në rastin konkret mbetet në përgjegjësi të AK-së të merret ose mos merret e mirëqenë krahasimi dhe analizimi i sqarimit nga OE ankues. Rrpp nr.001/2022 neni 41.10: 41.10 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose: a. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose b. Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulet", brenda dy dite nga data e vendimit. Përderisa, sa i përket arsyes shtesë të AK-së në letrën standard B42 lidhur me shkëputjen e kontratës të OE ankues për një aktivitet tjetër për mos realizim të kontratës, bazuar në nenin 56.3 të LPP-së, AK vlerësimin duhet ta bëjë konform kërkesave të vendosura në DT, dhe se përderisa nuk ka ndonjë vendim nga Gjykata bazuar në interpretimin e KRPP-së pyetja nr. 17 e datës 22.11.2022, atëherë nuk mund të eliminohet i njëjti. Si e tillë pretendimi I OE ankues gjendet i bazuar. Si përfundim, sipas sqarimeve më lartë, AK një OE nuk mundet ta eliminoj me arsyetimin për papërshtatshmëri,

përderisa nuk ka ndonjë vendim nga Gjykata, mirëpo sa i përket arsyes së eliminimit për çmimet jo noramlisht të ulëta, atëherë bazuar në rregulloren e prokurimit publik nr.001/2022 neni 41.10, AK posedon diskrecionin që të vlerësoj sipas bindjes së tyre, dhe arsyetimin e mos marrjes si të mirëqenë çmimet nëpër pozicionet e caktuara. Andaj si e tillë ankesa e OE ankues kualifikohet si pjesërisht e bazuar, kurse rekomandohet që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues ''Axiom Engineering'' Sh.P.K. Argumentimi në raportin e eksperteve është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues mbështet raportin e ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues Axiom Engineering Sh.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e Renovimi i depos për ARC në objektin e ish Rilindjes me numër të prokurimit 214-24-6659-5-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik Axiom Engineering Sh.P.K., te aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me Renovimi i depos për ARC në objektin e ish Rilindjes me numër të prokurimit 214-24-6659-5-2-1 të mbetet në fuqi vendimi i AK per anulim të aktiviteti.

Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës,si dhe njoftimin ne KRPP nga ana e AK-se lidhur me tenderin jo-normalishtë të ulët, ankesën e operatorit ekonomik Axiom Engineering Sh.P.K., e sheh si pjesërisht të bazuar.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahimi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **AXIOM ENGINEERING SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: